



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 123, Datë 11.05.2021

MBI

RISHIKIMIN E VENDIMIT NR.13, DATË 20.01.2021, PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË ENERGY SUPPLY- AL” SH.P.K., NR. 115/309, SERIA T11/T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 11.05.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr. 68/1 prot, datë 04.05.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me plotësimin e kushteve të vendimit nr. 13, datë 20.01.2021, mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “ENERGY SUPPLY -AL” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatohet se:

- ERE me vendimin nr. 13, datë 20.01.2021, vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “ENERGY SUPPLY–AL” sh.p.k., me nr. 115/309, Seria T11/T15, të shoqërisë “Energy Supply-AL” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit nr. 6, datë 02.02.2011 dhe rinovuar me vendimin e bordit nr. 122, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 04.02.2021, me kusht që përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së licencuar të depozitohet në ERE:

- a. Vërtetimet përkatëse të gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin me prokurë.*
- b. Dokumentacion vërtetues ku të shprehen qartë vlerat monetare dhe aftësia paguese e shoqërisë mëmë që ka marrë përsipër të mbështesë shoqërinë “ENERGY SUPPLY– AL”, apo strukturën e financimit.*

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE pasi të analizohet dokumentacioni i përcjellë nga shoqëria “ENERGY SUPPLY– AL” sh.p.k. sipas kërkesave të pikës 1, të këtij vendimi.

- Në vijim të sa më sipër shoqëria “ENERGY SUPPLY– AL” sh.p.k. me shkresën nr. 299/6, datë 21.04.2021, përcolli dokumentacionin e munguar.
- Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë në ERE nga shoqëria “ENERGY SUPPLY - AL” sh.p.k., në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 13/2021, rezulton si më poshtë:
 - Kushti i vendosur në pikën 1 gërma “a. Vërtetimet përkatëse të gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin me prokurë”, të vendimeve nr. 13/2021 dhe nr. 14/2021, **është plotësuar nga shoqëria “ENERGY SUPPLY– AL” sh.p.k..**
 - Kushti i vendosur në pikën 1 gërma “b. Dokumentacion vërtetues ku të shprehen qartë vlerat monetare dhe aftësia paguese e shoqërisë mëmë që ka marrë përsipër të mbështesë shoqërinë “ENERGY SUPPLY– AL”, apo strukturën e financimit”, të vendimit nr. 13/2021, **është plotësuar nga shoqëria “ENERGY SUPPLY– AL” sh.p.k..**

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. **Të ndryshojë pikën 1, të vendimit të ERE nr. 13, datë 20.01.2021, si vijon:**
Të rinovojë licencën e shoqërisë “Energy Supply–AL” sh.p.k., me nr. 115/309, Seria T11/T15, të shoqërisë “Energy Supply- AL” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit nr. 6, datë 02.02.2011 dhe rinovuar me vendimin e bordit nr. 122, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 04.02.2021.
2. Gërmat “a” dhe “b”, të pikës 1 dhe pika 2, e vendimit nr. 13/2021 shfuqizohen.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI